

VENDIM
Nr. 243, datë 3.4.2013

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF13972, NDËRMJET SHQIPËRISË
DHE BANKËS PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), QË VEPRON SI
ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA NGA DISA DONATORË, PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT “NGRITJE E KAPACITETEVE DHE MBËSHTETJE PËR
ZBATIMIN E SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR (SPI)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF13972, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve grant, të siguruara nga disa donatorë, për financimin e projektit “Ngritje e kapaciteteve dhe mbështetje për zbatimin e sistemit të planifikimit të integruar (SPI)”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha